



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351-162047

Dt. 19.09.2016

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e **Jakup Gashi** nga **Prizreni** me banim në rrugën **“Mbreti Piro”** në bazë të nenit 3 alineja 1 pika 7 e lidhur me nenin 17 të ligjit për planifikim hapësinor me nr.04L/174 të dt.31.07.2013, si dhe nenit 3 alineja 1 pika 1.1,1.2,1.4,1.16,1.17,1.20,1.24 si dhe nenit 5 alineja 1 pika 1 si dhe nenit 14 alineja 1 pika 1 dhe në lidhje me nenin 15 alineja 1 pika 2 dhe nenit 19 alineja 2 të ligjit për ndertim nr. 04/L-110, si dhe konform Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban “Qendra e Re-2” nr.-01/011-5300 të dt.20.05.2011, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82,83,84,85 e në lidhje me nenin 86. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

AKTVENDIM

- I. **ILEJOHET: Jakup Gashi** që të ndërtoj objektin e rinj - **Shtëpi individuale** - në Prizren në vendin e ashtuquajtur **“ / “** rrugën **“Mbreti Piro” nr.125/1** në ngastrën kadastrale e cila është e identifikuar në Aktin mbi kushtet për rregullimin e hapësirës nr. **04-353-131243** si dhe me Aktvendimin mbi lokacionin e objektit, sipas dokumentacionit teknik e cila është e hartuar nga ana e **byrosë projektuese N.P.T.SH.”ARCHING”**.
- II. Dokumentacioni Teknik e mbanë titullin e tipit **vecantë**.
- III. Parallogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **112.911,65 €**.
- IV. Ndërtimi i objekteve ndihmëse s’është e lejuar si dhe vlera e këtyre objekteve, është përjashtuar nga parallogaria e vlerës së objektit.
- V. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë me shkrim organin kompetent (inspektionin e ndërtimtarisë) në afat prej 8ditësh.
- VI. Pas përfundimit të ndërtimit të objektit investitori duhet të parashtrijë kërkesë për marrjen e lejes për përdorim.
- VII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se investitori me punë nuk fillon brenda afatit prej 12 (dymbëdhjet) muajsh duke llogaritur nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit.
- VIII. Kunjëzimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas kushteve urbanistike si dhe dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori, të njëjtit të vërtetuar në aktin mbi kushtet e rregullimit të hapësirës
- IX. Pronarët e pronave fqinje kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e dhënies së lejes së ndërtimit (shikimin e dokumentacionit).
- X. Investitori është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte, ngase është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjes, kanalizimit, PTK, KEDS-it, Dukagjinit dhe avari tjera ti evitojë dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejt kompensimi.

.../...

A r s y e t i m

Parashtruesi i kërkesës: Jakup Gashi nga **Prizreni** me banim në rrugën **“Mbreti Piro” nr. 125/1** i është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes së ndërtimit për ndërtim të **objektit - Shtëpi individuale.**

Duke shfletuar dokumentacionin teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara këtij organi s’bashku me kërkesë vërtetohet se:

Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.


Që parashtruesi i kërkesës ka miratuar të gjitha pagesat rreth ndërtimit të objektit si dhe s’bashku me kërkesë në shtojcë ka parashtruar këto dokumente të duhura: kopjen e planit, listën poseduese, aktvendimin mbi bartjen e pronësisë, me të cilat i ka zgjidhur marrëdhëniet pronësoro – juridike, Aktin mbi kushtet e rregullimit të hapësirës, aktvendimin mbi lokacionin, dëftesë pagesat që i ka paguar kontributet për rregullimin e tokës ndërtimore, si dhe projektet.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi ndërtimin e të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes së ndërtimit.

Nga se u tha më lartë u muarr aktvendimi si në dispozitiv.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE; Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, përmes këtij organi.

Ankesa taksohet me 0.50 Euro taksa administrative.

Bashkëpunëtor profesional

Xhejlane Gjini inxh.dip.ark.

